

GAZETA
SHQIPTARE

Fillimi > -Kronikë

Me pistoletë në mes të Durrësit, pranga 19-vjeçarit

06 Gusht, 2019 15:49 | 1 shfletime



Madhësia e tekstit:





Pas kontrolleve të ndermarra për të garantuar rendin dhe sigurinë publike, Policia e Shtetit ka vënë në pranga një 19-vjeçar në Durrës, ku pas verifikimeve të kryera rezultoi se mbante armë me vete dhe një krehër me fishekë. Blutë e qytetit bregdetar njoftojnë se në pranga është vënë një 19-vjeçar nga Shkodra.



Njoftimi i policisë:

“Evidentohet dhe goditet një tjetër rast i armëmbajtjes pa leje. Arrestohet në flagrancë 19 – vjeçari që qarkullonte me pistoletë me silenciator.

Në vijim të punës për parandalimin dhe goditjen e paligjshmërisë si dhe në zbatim të planit të masave për kapjen e personave që qarkullojnë me armë zjarri, nga Shërbimet e Stacionit të Policisë Plazh dhe Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Durrës, është arrestuar në flagrancë shtetasi:

-S. Xh., 19 vjeç, banues në Shkodër.

Ky shtetas është kapur nga Shërbimet e Stacionit të Policisë Plazh dhe Komisarariatit të Policisë Durrës, në afërsi të Shkëmbit të Kavajës dhe gjatë



kreher me 5 fisheke.

Materialet hetimore i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Durrës në ngarkim të shtetasit të mësipërm, për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”.



□ □

(n.m/BalkanWeb)

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)

Etiketa: arme arrestohet Durres i riu kapet